



Pranuar / Dorezuar Priljezi / Predato Received / Delivered	15. 11. 2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHCK	6989/2023		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKË QYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1181/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar dhe Kaltrina Avdullahi-Prenaj Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1181/2023 të datës 19.09.2023 të parashtruar nga ankuesja Nazmije Beqiri të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Avokat Rexhep Potera me adresë: Rruga „Egnatia“ nr.5, Komuna e Prishtinës, kundër Vendimit me numër KA.Nr.28/2023 i datës 15.08.2023, në çështjen juridike „Masë disiplinore“, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 15.11.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet e pabazuar ankesa me numër A.nr.1181/2023 e datës 19.09.2023 e parashtruar nga ankuesja Nazmije Beqiri.

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër KA.Nr.28/2023 i datës 15.08.2023, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Këshillin Prokurorial të Kosovës.

A r s y e t i m

Ndaj ankueses Nazmije Beqiri e punësuar sipas Akt Emërimit me numër protokolli Nr. ZBNJ/DP-217/2015 të datës 03.11.2015 në pozitën e punës „Zyrtare Ligjore“ në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, administratorja e Prokurorisë Themelore në Prishtinë më datë 20.06.2023 përmes Aktit administrativ me numër A.nr.132/2023 i ka shqiptuar masën

disiplinore „Vërejtje me shkrim“ për shkak të shkeljes së Kodit të Etikës Profesionale për Punonjësit Mbështetës.

Ankuesja kundër „Vërejtjes me shkrim“ të datës 20.06.2023 të shqiptuar nga administratorja e Prokurorisë Themelore, më datë 20.07.2023 ka parashtruar ankesë në Komisionin për ankesa në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës. Ndërsa me datën 15.08.2023 Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave ka nxjerrë Vendimin me numër KA.Nr.28/2023 përmes së cilit e ka refuzuar ankesën e parashtruar nga ankuesja ndërsa aktin administrativ „Vërejtjen me shkrim“ me numër A.132/2023 të datës 20.06.2023.

Ankuesja e pakënaqur me Vendimin me numër KA.Nr.28/2023 të datës 15.08.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës, përmes avokatit Rexhep Potera, më datë 19.08.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 6150/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 25.09.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës. Ndërsa Këshilli, më datë 29.09.2023 ka pranuar përgjigjen së bashku me të gjitha shkresat e lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Vendimin me numër VK/2023 dhe numër të protokollit 6806/2023 të datës 01.11.2023 ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr.118/2023 edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli 6150/2023 të datës 19.09.2023 të parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar Av. Rexhep Potera në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër KA.Nr.28/2023 të datës 15.08.2023 të nxjerrë nga Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Pliko me numër R 5498746 e datës 18.09.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 25.09.2023; Përgjigje në ankesë e datës 29.09.2023; Akt Emërimit me numër protokoli Nr. ZBNJ/DP-217/2015 të datës 03.11.2015; E-mail i datës 25.09.2023; Përshkrimin e detyrave të punës; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 01.01.2021 deri më datë 31.01.2021; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 01.01.2022 deri më 31.12.2022; Vërejtja me shkrim me numër A.nr.132/2023 e datës 20.06.2023; E-mailat e datës 19.06.2023; E-mail i datës 16.06.2023; Shkresë zyrtare nga takimi i mbajtur me prokuroren J.G të datës 01.08.2023; Shkresë zyrtare nga takimi i mbajtur me R.K zyrtar i lartë i IT-së e datës 01.08.2023; Vendimin me numër VK/2023 të datës 01.11.2023 me numër protokoli 6806/2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankueses, *është e pabazuar, sepse:*

Ankuesja në ankesën me numër protokollit 6150/2023 të datës 19.09.2023 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër KA.Nr.28/2023 të datës 15.08.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave dhe aktit administrativ „*Vërejtjes me shkrim*“ me numër A.nr.132/2023 të datës 20.06.2023, pretendon se shkelja e pretenduar nga ana e mbikëqyrëses së drejtpërdrejtë nuk parashihet si sjellje e pahijshme; nuk ka ndodhur shkelja e pretenduar, gabimisht janë konstatuar rrethanat faktike si dhe vërejtja me shkrim si masë e shqiptuar ndaj meje është disproporcionale me rrethanat e veprimeve të mija dhe jo oportune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas administrimit të provave të lëndës ka konstatuar se më datë 20.06.2023 Administratorja e Prokurorisë Themelore në Prishtinë përmes aktit administrativ me numër A.nr.132/2023 në cilësinë e mbikëqyrëses së drejtpërdrejtë i ka shqiptuar ankueses „*Vërejtjen me shkrim*“, me arsyetimin se e njëjta më datë 16.06.2023, rreth orës 14:10 e ka hapur derën e zyrës së Udhëheqëses së Departamentit të Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Prokurores J.G pa autorizimin e saj përmes kodit i cili kod është i përgjithshëm për hapjen e të gjitha dyerve të zyrave, nga rrjedhë se ankuesja Nazmije Beqiri e ka keqpërdorur kodin të cilin e ka poseduar për hapjen e derës së zyrës së saj, duke i hapur edhe dyert e tjera, në rastin konkret të zyrës së Prokurores J.G, andaj mbi këtë bazë e njëjta ka bërë shkelje të lehta të Kodit të Mirësjelljes për nëpunësit civil dhe Kodit të Etikës Profesionale për Punonjësit Mbështetës.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankueses, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka shqyrtuar në tërësi provat materiale të lëndës dhe mbi bazën e administrimit të tyre ka konstatuar se, për sa i përket pretendimit se shqiptimi i „*Vërejtjes me shkrim*“ nga mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë në këtë rast, Administratorja e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, është në kundërshtim me Rregulloren me numër Nr.04/11 për Procedurat Disiplinore në Shërbim Civil, Kolegji i Këshillit me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit administrativ konkretisht „*Vërejtjes me shkrim*“ të shqiptuar ndaj ankueses i u referua nenit 7 paragrafit 1.2 dhe paragrafit 2 të Rregullores me numër Nr.04/11 për Procedurat Disiplinore në Shërbim Civil ku përcaktohet qartë se: 1.2, „*Vërejtja me shkrim nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë shqiptohet në proporcion me pasojat e shkaktuara dhe vendoset në dosjen personale të nëpunësit civil*“ 2. „*Shqiptimi i masës së paraparë me nënparagrafin 1.1 të këtij neni bëhet brenda dy (2) ditëve të punës; kurse për masat e parapara me nënparagrafët 1.2 dhe 1.3 të këtij neni duhet të bëhet brenda shtatë (7) ditëve prej kur dyshohet se është kryer shkelja*“, andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstaton se shqiptimi i „*Vërejtjes me shkrim*“ ndaj ankueses për nga aspekti procedural është në pajtim me dispozitat e lartcekura, sepse kështu që ky pretendim i ankueses është i pabazuar.

Për sa i për ketë pretendimit ankimor të ankueses, se hapja e derës së zyres së Udhëheqëses së Departamentit të Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, prokurorës J.G ka ndodhur instiktivisht pasi që ajo e ka zyrën në drejtimin e njëjtë me prokuroren J.G vetëm në katin e II-të dhe se nuk ka qenë në dijeni e as e informuar nga administrata e Prokurorisë Themelore në Prishtinë se kodi i zyrës së saj është i njëjtë me kodin e zyrës së prokurores J.G, pasi që krijimi i kodeve është punë e zyrtarëve të IT, ndërlidhur me këtë Kolegji i Këshillit i u referua procesverbalit të datës 01.08.2023 të deklarimeve të prokurores J.G dhe zyrtarit të Teknologjisë Informative R.N, ku në bazë të deklaratës së Prokurores J.G „nuk ishte hera e parë që ankuesja e kishte hapur derën e saj pa autorizim sepse rasti i parë kishte ndodhur diku në muajin Mars-Prill ndërsa rasti i dytë në Qershor, nga rrjedhë se e njëjta ndihet e shqetësuar për faktin se personat që nuk janë pjesë e zyrës së saj të kenë qasje në kodin e zyrës,, ndërsa bazuar në deklaratën e zyrtarit të Teknologjisë Informative R.N „ i njëjti ka theksuar se është e vërtetë që fillimisht është krijuar sistemi i hapjes së deryeve me kod, kodi ka qenë i njëjtë për të gjitha dyert e objektit, mirëpo pas informimit të administratores kodet janë ndëruar dhe janë bërë të veçanta, gjithashtu ka theksuar se kodin e përgjithshëm e ka pasur edhe prokurori H.B deri sa të pajiset me kartel e të cilin kod e ka pasur edhe ankuesja Nazmije Beqiri pasi që e njëjta punon në zyrën e prokurorit H.B, e po ashtu ka theksuar se mund të jetë e rastësishme hapja e derës gabimisht për herë të parë por nëse e njëta përsëritet atëherë nuk mund të jetë më rastësi “, andaj bazuar në dëshmitë e ofruara dhe duke marrë pasur parasysh faktin se ankuesja e ka përsëritur shkeljen e njëjtë dhe nuk e ka njoftuar Administratoren lidhur me rastin respektivisht nuk ka dërguar shkresë apo e-mail për te sqaruar rastin, Kolegji i Këshillit konstaton se ankuesja ka bërë shkelje të detyrave të punës gjegjësisht ankuesja me veprimet e saj ka bere shkelje disiplinore siç parashihet me nenin 5 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1 të Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *“1.Shkeljet të lehta disiplinore konsiderohen: 1.1.shkeljet e lehta të Kodit të Mirësjelljes për nëpunësit civilë, “.*

Andaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha provave të bashkangjitura në shkresat e lëndës, konstaton se Administratorja e Prokurorisë Themelore në Prishtinë në cilësinë e mbikëqyrëses së drejtpërdrejtë, me rastin e shqiptimit të masës disiplinore „*Vërejtje me shkrim* “ përmes aktit administrativ me numër A.nr.132/2023 të datës 20.06.2023 ndaj ankueses ka konstatuar saktë përgjegjësinë disiplinore të ankueses si dhe ka cilësuar drejtë veprimet e ankueses si shkelje të lehta disiplinore siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, respektivisht me nenin 66 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: *“Masat disiplinore zbatohen në mënyrë graduale dhe në proporcion me pasojat dhe dëmet e shkaktuar nga sjellja e nëpunësit civil”,* „*2.Shkeljet e detyrave të punës ndahen në: shkelje të lehta dhe shkelje të rënda - serioze.....* ndërsa me nenin 67 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 pika 1.1.2, përcaktohet se: *“Vetëm këto masa disiplinore mund të zbatohen për shkeljen e detyrave të përcaktuara me këtë ligj: 1.1. për shkelje të lehta aplikohen masat disiplinore në vijim: 1.1.1. paralajmërimi nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë; 1.1.2..vërejtja me shkrim nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. 1.1.3. vërejtje me shkrim dhe mbishkrimi në dosjen personale të nëpunësit civil nga organi përgjegjës për menaxhimin e personelit*

në institucion" dhe nenin 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit, konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës me rastin e nxerrjes së Vendimit me numër KA.Nr.28/2023 të datës 15.08.2023 përmes të cilit është refuzuar ankesa e ankueses Nazmije Beqiri si e pabazuar, të njëjtin e ka arsyetuar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil dhe Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjen së Kontesteve dhe Ankesave, ngase janë shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore të ankueses në pajtim me nenin 48 ndërlidhur me nenin 134 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrtës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr. 1181/2023

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Avokatit Rexhep Potera
- Njesisë së Burimeve Njerëzore në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.